

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Majko: Vendimi i Hagës nuk e ndryshon historinë, por dëshmon lidhjen e pandashme mes Kosovës dhe Shqipërisë
ADRESA	https://albeu.com/kosove/majko-vendimi-i-hages-nuk-e-ndryshon-historine-por-deshmon-lidhjen-e-pandashme-mes-kosoves-dhe-shqiperise/1015160/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 20:53:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 20:50:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	597c843108e7397a03e8c64bc000be941d75ca854794cdad23bed7b9cc30e78b
TEKSTI	5984cc18a9c009178282080e33ef189b6db31a1e97786fdd1149f6aab0f68ee2
PAMJA	89a4500bb9125ba848700ccf40211446b1d7649f8d3ce93460d4719e76582850

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c403ab9717c48ada14a5187ca39b2c87ee3e25a3fb857f51d197c1251acd4665
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	26ca1211810c15876c42328b01c67c994b772de7f527230561d5cde24b5bf9b0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c403ab9717c48ada14a5187ca39b2c87ee3e25a3fb857f51d197c1251acd4665>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Majko: Vendimi i Hagës nuk e ndryshon historinë, por dëshmon lidhjen e pandashme mes Kosovës dhe Shqipërisë



Ish-kryeministri shqiptar gjatë Luftës së Kosovës, Pandeli Majko, e ka cilësuar verdiktin e sotëm të Gjykatës së Hagës si një vendim dramatik, i cili, sipas tij, nuk mund ta rishkruajë historinë.

Majko e ka përjetuar këtë zhvillim edhe në planin personal. Gjatë viteve të luftës në Kosovë, ai drejtonte qeverinë e Shqipërisë, ndërsa Hashim Thaçi ishte një prej udhëheqësve të UÇK-së dhe anëtar i delegacionit të Kosovës në Rambuje.

Sipas tij, Thaçi ishte në krye të delegacionit të Rambujesë, një proces që për herë të parë e vendosi Kosovën si subjekt të të drejtave ndërkombëtare. Majko e përshkroi atë si luftëtar dhe drejtues, duke theksuar se ndihet krenar që e ka pasur mik dhe se miqësia e tyre do të jetë edhe më e fortë tani.

Duke folur për Top Channel, ish-kryeministri tha se vendimi përbën një dramë të jashtëzakonshme njerëzore. Ai shprehu gjithashtu shqetësimin se, me kalimin e kohës, ky proces mund të ndikojë në mënyrën se si do të perceptohet historikisht lufta e Kosovës.

Majko nënvizoi se vendimi i një gjykate ndërkombëtare nuk e ndryshon të kaluarën, ndërsa pesha që do të marrë në të ardhmen do të varet nga rrethanat. Megjithatë është folur për një rezultat që e nxjerr UÇK-në të pastër, ai tha se ndihet pesimist, pasi, sipas tij, prej disa kohësh po tentohet deformimi i historisë së saj.

Ai shtoi se nuk mund të thuhet se UÇK-ja ka dalë e papërlyer nga kjo histori, pasi mbetet fakt se pjesëtarë të saj janë vrarë ose dënuar. Për Majkon, kjo është një dramë që kërkon të kuptohet dhe të vlerësohet në thellësinë e saj.

Ish-kryeministri u bëri thirrje Kosovës dhe Shqipërisë të reagojnë me dinjitet dhe të mos hyjnë në përplasje me

të fundit /



Apeli nuk pritet ta ndryshojë vendimin? Avokatja përlohet për...



Al-Taawoun dënohet pas thirrjeve fyese të tifozëve ndaj Ruben...



Franca rikonfirmon mbështetjen për pavarësinë dhe...



Ka mbi 6 muaj pa paguar, avokatët e Diddy-t kërkojnë të...



Besnik Tahiri: Aktgjykimi i Speciales ndaj ish-krerëve të...



Fotot zbulojnë pasojat e sulmeve iraniane në bazat amerikane në...



"Le Monde" pas aktgjykimit në Hagë: Gjykatë e debatuesh...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

drejtësinë. Duke iu referuar pamjeve pas vendimit, ai tha se njerëz, fëmijë dhe ish-ushtarë të UÇK-së janë parë duke qarë, çka tregon përmasën e jashtëzakonshme njerëzore të kësaj drame.

Majko theksoi se zemërimi ndaj gjykatës dhe fyerjet ndaj një vendimi gjyqësor nuk përbëjnë forcë, por dobësi. Sipas tij, ky zhvillim e ka bërë të qartë se Kosova nuk ka tjetër përveç Shqipërisë dhe Shqipëria nuk ka tjetër përveç Kosovës.

Ai kujtoi se beteja ligjore nuk ka përfunduar, pasi tashmë mbetet edhe faza e Apelit. Për këtë arsye, Majko kërkoi që çështja të mos shihet vetëm si një goditje ndaj individëve të dënuar, por si një akt që ka prekur të gjithë, duke vënë në dukje se gjatë luftës është e vështirë të ndahet përgjegjësia personale nga ajo kolektive.

Gjykata Speciale u themelua në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës, pas ndryshimeve kushtetuese dhe marrëveshjeve të arritura me Bashkimin Evropian. Majko e konsideroi pranimin e saj një çmim që Kosova zgjodhi ta paguante në rrugën drejt konsolidimit të saj ndërkombëtar.

Sipas tij, krijimi i kësaj gjykate kërkonte një nivel të caktuar guximi dhe nuk mund të përdoret si bazë për akuza ndaj Kosovës në planin ndërkombëtar apo historik. Majko tha se ndërgjegjja e shqiptarëve e di se gjithçka është paguar ose me vrasje, ose me burgosje, duke shtuar se ata nuk i zhgënjyen.

Shtuar më 16.09.2026 22:50

Tags: [haga](#), [kosova](#), [pandeli majko](#)



Apeli nuk pritet ta ndryshojë vendimin"/ Avokatja përlotet për ish-liderët e UÇK-së:...



Besnik Tahiri: Aktgjykimi i Speciales ndaj ish-krerëve të UÇK-së është politik



"Le Monde" pas aktgjykimit në Hagë: Gjykatë e debatueshme që pranoi...



Pamje të reja nga bastisja e shtëpisë së Jakup Krasniqit, hetuesja Zdenk...



Shqipëria angazhon 17 ushtarakë dhe një helikopter në misionin e...



Ambasadori gjerman bën thirrje që aktgjykimi të respektohet



Mitrovica në heshtje pas aktgjykimit të Hagës



Berisha reagon ndaj aktgjykimit në Hagë: Vendim i paprecedentë,...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Vellaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.